



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Handwritten signature in blue ink.

Nr. 3780 Prot

Tiranë, më 30/11 2018

Lënda: Amendament për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”

Drejtuar: z. Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Mbështetur në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, propozoj që në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

- Në nenin 4, pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Pas shkronjës g), shtohen shkronjat gj) dhe h), me këtë përmbajtje:

gj) ndërtesat që janë në pronësi apo në përdorim të organizatave jofitimprurëse, të licencuara nga organet e qeverisjes qendrore dhe që kanë lidhur marrëveshje me organet e qeverisjes qendrore apo vendore, si ofrues shërbimesh komunitare, për personat me aftësi ndryshe.

h) ndërtesat që përdoren nga personi fizik ose juridik, që ushtron tërësisht, veprimtarinë e shitjes së librave në mjedise tregtare.”

DEPUTETI

Handwritten signature of Erjon BRACE in blue ink.
Erjon BRACE